

VENDIM
Nr.673, datë 6.10.2011

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2011, MIRATUAR PËR DREJTORINË
E SHËRBIMEVE QEVERITARE, PËR RIPARIMIN E MBULESËS SË SALLËS SË MADHE
TË KONCERTEVE, NË PALLATIN E KONGRESEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, në buxhetin e miratuar për vitin 2011, t’i shtohet fondi prej 4 000 000 (katër milionë) lekësh, për riparinin e mbulesës së sallës së madhe të koncerteve, në Pallatin e Kongreseve.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.

3. Ngarkohen Kryeministria, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha